



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2022:121692

Datë: 12.04.2024

Numri i dokumentit: 05566987

C.nr.158/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Artan Abazi, me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses J. T. nga, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Vasilije Arsic avokat nga Ranilluku, kundër të paditurës Komuna e Ranillukut – Departamenti i Shëndetësisë dhe Arsimit, me seli në Ropotovën e Madhe, me objekt kontesti, padi për pagesën e pagës jubilarë, me vlerë të kontestit prej 447.00 €, jashtë seancës, më datën 20.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APPROVOHET në tërësi si e bazuar kërkespadija e paditëses J. T. nga dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Ranillukut – Departamenti i Shëndetësisë dhe Arsimit, me seli në Ropotovën e Madhe që paditëses, t’ia paguajë vlerën e një page bazë në shumë prej 447.00 euro, në emër të shpërblimit jubilar, me kamatë ligjore prej 8%, në vit, duke filluar nga data 09.06.2022, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarrimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës, t’ia paguaj paditësit shumën prej 125.00 €, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarrimit ligjor, ndërsa refuzohet shuma prej 10.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj me datën 09.06.2022, ka paraqitur padi kundër të paditurës me objekt kontesti padi për shpërblimin jubilar, me vlerë të kontestit prej 447.00 €. Në padi paditësi ka theksuar se është në marrëdhënie pune te e paditura. Kërkesën e tij paditësi e ka bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale (më tej: KKS), konkretisht në nenin 17 pargarfi 3, duke theksuar se **“Punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e shpërblimit jubilar për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”**. Meqenëse e paditura nuk i ka paguar vullnetarisht mjetet të cilat ka qenë e obliguar t’i paguaj, paditësi kërkon nga gjykata që të aprovohet si e bazuar kërkespadija e paditësit dhe të detyrohet e paditura t’ia paguaj shumën prej 447.00 me kamatë ligjore prej 8

% nga dita e paraqitjes së kësaj padisë. Gjithashtu e njëjta i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës duke i specifikuar edhe atë: për hartimin e padisë shumën prej 104.00 euro si dhe për taksë gjyqësore shumën prej 31.00 euro.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, e ka kundërshtuar kërkesëpadinë duke theksuar se Komuna e Ranillugut si palë e paditur nuk është nënshkruese e Marrëveshjes me Sindikatat Shëndetësore të Republikës së Kosovës, andaj edhe Marrëveshja Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë nuk vlen për punëtorët e Komunës së Ranillugut, kurse nuk e ka kontestuar gjendjen faktike dhe faktet vendimtare, se paditësja është në mardhënie të punës tek e paditura, se ka pagën bazë në lartësi prej 447.00 € dhe se Kontrata Kolektive Sektoriale në nenin 17, pika 3 e saj, e ka rregulluar këtë materie, duke cituar dispozitat ligjore sa i përket shpërblimit të pagave jubilarë për vitet e punës.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (më tej: LPK) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se e paditura i ka pohuar faktet vendimtare si dhe nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë, dhe në mungesë të mjeteve buxhetore ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara, për faktet e pohura konform nenit 398 të LPK-së.

Gjykata ka vlerësuar se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja punon tek e paditura, fakt ky i cili dëshmohet edhe përmes Kontratës së Punës me nr.01-077, të datës 10.03.2011, paga e së cilës është 558.00 euro, fakt ky i cili vërtetohet përmes qarkullimit të llogarisë bankare të datës 04.05.2022 në emër të paditëses.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritorë në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga e paditura, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësi është në mardhënie të punës tek e paditura, dhe se Kontrata Kolektive Sektoriale me nr. 05-3815 e datës 12.06.2018 në nenin 17, pika 3 e saj, e ka rregulluar këtë materie, pasi që në nenin përkatës shprehimisht është përcaktuar se *“Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit për 10 vjet të përvojës së punës në Institucione Shëndetësore, në vlerë të një page mujore.*

Lidhur me pretendimet e të paditurës se në rastin konkret Marrëveshja Sektoriale e Shëndetësisë nuk vlen për Komunën e Ranillugut, për gjykatën një pretendimi i tillë nuk qëndron, pasi se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditësit edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive Sektoriale me nr 05-3815, e datës 12.06.2018, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë ushtron efekt tek punëtorët shëndetësor dhe administrativ në institucione shëndetësore.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispoziten e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve/ *Ligji nr. 04/L-077 date 19.06.2012/*.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së, kurse refuzoi shumën prej 10.00 euro sepse vlera e objektit të kontestit është nën 500.00 euro, ashtu që, shuma për përpilimin e padisë është 78.00 euro dhe jo 104.00 euro siç pretendon paditësi. Sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Dega në Kamenicë
C.nr.158/2022, dt.20.02.2024

Gjyqtari,
Artan Abazi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.